

**LIGJ**  
**Nr. 8937, datë 12.09.2002**

**PËR RUAJTJEN E NXEHTËSISË NË NDËRTESA**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**VENDOSI:**  
Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të krijojë bazën ligjore të nevojshme për vendosjen e rregullave dhe bërjen të detyrueshme të marrjes së masave për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa.

Neni 2

Për qëllimet e këtij ligji, termat e përdorura kanë këto kuptime:

“Ndërtesë” do të thotë një ngrehinë, një bashkësi lokalesh, mjedis banimi, shërbimi e prodhimime karakter public ose privat.

“Instalim termik” do të thotë bashkësi pajisjesh termike së bashku me rrjetin lidhës, që shërbejnë për ngrohjen dhe ftohjen e mjedisit të brendshëm të ndërtesave.

“Ngrohje qendrore” do të thotë një imiant ngrohjeje, që furnizon me energji termike një ose më shumë apartamente.

“Ngrohje lokale” do të thotë një imiant ngrohjeje, që furnizon me energji termike një grup ndërtesash të ndara nga njëra-tjetra.

Neni 3

Projektimi dhe ndërtimi i ndërtesave të realizojë parametra teknikë të nevojshëm për ruajtjen, kursimin dhe përdorimin me efikasitet të energjisë. Të gjitha ndërtesat që do të ndërtohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji të respektojnë koeficientin vëllimor e normative të humbjeve termike (Gv), si dhe të parashikojnë vendosjen e instalimit termik të ngrohjes qendrore ose vendore.

Neni 4

Instalimet e prodhimit të nxehtësisë (gjeneratorët e nxehtësisë ose/dhe pompat e nxehtësisë) për ngrohjen dhe/ose freskimin e ndërtesave projektohen për arritjen e temperaturës së ajrit të brendshëm, sipas normave të komfortit të temperaturës, duke marrë parasysh kushtet klimatike sezonale dhe anën funksionale të ndërtesës.

Neni 5

Këshilli I Ministrave përcakton normat, rregullat, dhe kushtet e projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe të ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.  
**Shpallur me dekretin nr.3484,dt.7.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**z.Alfred Moisiu.**